



Prishtinë: 30.06.2009

Kodi i ZRRE-së: V\_197\_2009

Nr. I Referencës: ZRRE/DMK\_R\_234\_06\_09

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: ZRRE/DMK\_V\_234\_06\_09;
5. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

**Në mbledhjen e mbajtur më 30 qershor 2009 nxori këtë:**

### VENDIM

**PRANOHET** ankesa e konsumatorit Ekrem Vuçitërna nga Prishtina (shifra e konsumatorit DPR – 90012010) , si në arsyet e paraqitura të këtij rekomandimi.

### Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK të ZRRE-së të 08.01.2009 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 02.10.2008, lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Në muajin 04/2008 zyrtarët e KEK-ut kanë vizituar objektin e konsumatorit me qëllim të ndërrimit të njehsorin elektrik, ku kanë larguar nga matja e konsumit të energjisë elektrike njehsorin elektrik me nr. 7781292 dhe kanë vendosur njehsorin elektrik nr. 10465846.  
**Provë:** Vërtetimi i ndërrimit të njehsorit elektrik nr. 003697
- Me datë 25.06.2008 Qendra e Kalibrimit në KEK ka bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik ku gjatë kontrollimit kanë konstatuar se qelqi i njehsorit elektrik është i thyer, kapaku i epërm është i shpuar (ka vrimë) ku përmes kësaj vrime është penguar puna e diskut.  
**Provë:** Procesverbali i Qendrës së Kalibrimit në KEK nr. 20/25 të datës 25.06.2008
- Me datë 25.08.2008 ekipi i autorizuar i KEK-ut ka vizituar objektin e konsumatorit me qëllim të regjistrimit të parametrave teknik të pikës matëse të konsumatorit.  
**Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 177672 të datës 25.08.2008

- Me datë 03.09.2008 KEK-u e ngarkon konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPR08HP06663 në vlerë prej 7,189.25 €.  
**Provë:** Fatura e KEK-ut DPR08HP06663 e datës 03.09.2008
- Me 25.09.2008 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 02.10.2008 Departamenti për Konsumator në KEK iu është përgjigjur konsumatori duke e refuzuar ankesën e konsumatorit mbështetur në procesverbalin e qendrës së kalibrimit dhe procesverbalin e kontrollës.  
**Provë:** Përgjigja e KEK-ut e 02.10.2008
- Me datë 08.01.2009 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së

DMK në ZRRE duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit dhe KEK-ut, ka vërejtur se:

- ✓ Sipas rrjedhjes së energjisë aktive dhe transaksionet e konsumatorit prej 02/2003 e deri 03/2004 nuk asnjë të dhënë për shpenzimin të energjisë.  
**Provë:** Rrjedhja e energjisë aktive dhe transaksionet e konsumatorit
- ✓ Me datë 30.03.2006 konsumatori është shkyçur nga rrjeti elektrik për shkak të borxhit në vlerën prej 1,701.14€, pas kësaj shkyçje konsumatori është faturuar për muajin 04/08, 05/08 dhe 06/08 pa matje edhe pse lexuesi në librin e leximeve ( listat e leximeve) shkruan se konsumatori nuk ka harxhim por nevojitet kontrole e njehsorit elektrik.
- ✓ Në procesverbalin nr 003697 të vërtetimit për ndërrimin e njehsorit thuhet se ndërrimi i njehsorit është bërë me kërkesën e konsumatorit, nuk është e kurtë se ndërrimi i njehsorit është bërë nga vetë konsumatori apo zyrtarët e autorizuar të KEK-ut, në ankesën e konsumatorit theksohet se për arsye të neglizhencës së punëtorëve të KEK-ut është detyruar që të bëjë ndërrimin e njehsorit duke informuar KEK-un për këtë veprim.
- ✓ Në muajin Prill 2008 ekipi i autorizuar i KEK-ut me anë të procesverbalit nr 003697 ka bërë pranimin e ndërrimit të njehsorit elektrik me nr 1046586 dhe ka dërguar në laboratorin e kalibrimit njehsorin me nr 7781292.
- ✓ Në procesverbalin e qendrës së kalibrimit është konstatuar se vulat shtetërore janë në rregull, qelqi është i thyer dhe se kapaku i epërm është i shpuar dhe se përmes kësaj vrime është penguar puna e diskut.
- ✓ Lexuesi në librin e leximit (listat e leximit të njehsorit elektrik) nga periudha 08/2006 deri në periudhën 04/2008 ka shënuar se ky konsumatorë nuk ka shpenzime të energjisë elektrike, por që nga periudha 05/2006 ka kërkuar që ky njehsor duhet të kontrollohet, ekipet përgjegjëse për kontrollimin e njehsorëve elektrik asnjëherë nuk kanë përfillur rekomandimin e lexuesit për kontrollimin e njehsorit elektrik me nr 7781292.

- ✓ Faturimi i rikthimit të energjisë së humbur me anë të faturës DPR 08HP06663 nuk është e drejtë për arsye se konsumatori gjatë periudhës për të cilën është faturuar nuk ka pasur shpenzim të energjisë elektrike, ky konstatim vjen duke u mbështetur në listat e leximit.
- ✓ Me datë 16.04.2008 konsumatori ka bërë pagesën e tërë borxhit në vlerën prej 2,976.81€, ka vendosur njehsorin e ri, është lexuar dhe faturuar, pas një periudhe pesëmuajore konsumatori faturohet me faturën e rikthimit të energjisë së humbur në vlerën prej 7,189.25€
- ✓ KEK-u gjatë llogaritjes së ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar ka gabuar ngase nuk ka përdorur tarifat të cilat kanë qenë aktuale me rastin e largimit të njehsorit por ka përdorur tarifat tjera të cilat janë aprovuar më vonë dhe nuk ka respektuar mënyrën e kalkulimit sipas procedurës për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar

DMK në ZRRE pas analizimit të dëshmive të paraqitura i rekomandon Bordit të ZRRE-së që të **pranojë** ankesën e konsumatorit.

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet e paraqitura dhe ka vendosur që ta **pranojë** ankesën e konsumatorit për arsyet e paraqitura në rekomandimin e DMK të ZRRE-së, Sipas këtij vendimi, KEK-u është i obliguar që:

- Shkarkoj konsumatorin nga fatura e rikthimit të humbjeve DPR08HP06663 të datës 03.09.2008 në vlerë prej 7,189.25€

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente të Prishtinës, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

#### **Bordi i ZRRE-së**

\_\_\_\_\_  
Dr. Ali Hamiti, kryesues

\_\_\_\_\_  
Përparim Kabashi, anëtar

\_\_\_\_\_  
Theranda Beqiri, anëtare

\_\_\_\_\_  
Blerim Koci, anëtar

\_\_\_\_\_  
Dr. Nysret Avdiu, anëtar